



Republika e Kosovës

Republika Kosova/Republic of Kosovo

Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Intervistimi forenzik i fëmijëve

Trajnuesi:

Kujtim Munishi

Prishtinë, 2022

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përmbajtja e këtij moduli është e AD-së, ndërsa pikëpamjet e autorëve nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Akademisë së Drejtësisë.

Ky material nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Akademisë së Drejtësisë.

Tabela e përmbajtjes

HYRJE

Intervistimi forenzik i femijëve	3
Objektivat mësimore	4
Metodat e të mësuarit	4
Pritjet nga pjesëmarrësit	4
Burimet dhe literatura.....	4
Hyrje.....	5
Standardet dhe rregulla për drejtim të procedurës në prokurori.....	6
Mbrojtja e fëmijëve viktime apo dëshmitarë.....	7
Marrja në pyetje e fëmijës.....	8
Marrja e drejtpërdrejtë në pyetje dhe marrja në pyetje në mënyrë të tërthortë.....	9
Ndalimi për t'u ballafaquar me të pandehurin.....	10
Standarde ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve.....	11
Burimet dhe literatura.....	12

Intervistimi forenzik i femijëve

1. Qëllimi i trajnimit

Përshkrim i përgjithshëm i temës

Konventa për të drejtat e fëmijës¹ në nenin 39 përcakton detyrime se shteti i ndërmerr të gjitha masat përkatëse për rimëkëmbje më të mirë fizike dhe psikike për reintegrim social të fëmijës viktimë të ndonjë forme të shpërfilljes; eksploatimit; keqpërdorimit; torturës ose ndonjë forme të veprimit mizor, johuman ose degraduese; dënimit dhe përlëshjes së armatosura. Rimëkëmbja dhe reintegrimi zhvillohet në mjedise, të cilat e stimulojnë shëndetin, vetërespektin dhe dinjitetin e fëmijës.

Intervistimi forenzik i fëmijëve mund të zbatohet në të gjitha format e dhunës, abuzimit ose shpërfilljes me të cilat kanoset ose cenohet integriteti fizik dhe psikik i fëmijës e të cilat paraqesin shkelje të njërës ndër të drejtave themelore të njeriut të mbrojtura me konventë.

Kohëve të fundit duke ndjekur trendin e vendeve të zhvilluara është nevojë standardizimi i procedurave dhe profilizimi i prokurorëve për vepra penale të ndryshme, në të cilat fëmijët janë viktimë të dhunës ose të veprave penale.²

Është shumë e nevojshme që organet e ndjekjes (Prokuroria dhe Policia) të posedojnë arsimim adekuat, njohuri të posaçme në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve-viktima.³

Standardet ndërkombëtare përcaktojnë kufi të caktuara minimale, të cilat duhet të hasen në çdo legjislacion nacional, me qëllim që të garantohet mbrojtja e fëmijëve viktimë të dhunës ose të veprave penale.

Në këtë kontekst standardet parashohin që:

- Marrjen në pyetje dhe format tjera të hulumtimit duhet t'i zbatojnë profesionistë të trajnuar, të cilët sillen me respekt ndaj fëmijës .
- Të gjitha kontaktet me fëmijën duhet të bëhen në mjedis adekuat, që do t'i përmbush nevojat e posaçme të fëmijës dhe në gjuhën që e kupton dhe e flet fëmija, me qëllim që të ketë mundësi më të volitshme për pjesëmarrje (bashkëpunim) nga vetë fëmija .,
- Fëmijët viktimë dhe dëshmitarë, prindërit ose tutorët e tyre, nga kontakti i parë me sistemin juridik duhet të informohen me kohë dhe në mënyrë adekuate për të drejtat e tyre ,
- Duhet të përcaktohen masa për të kufizuar kontaktet e panevojshme ndërmjet fëmijës dhe sistemit juridik, siç është kufizimi i numrit të intervistave të fëmijës (marrjes në pyetje) dhe përdorimi i video xhirimit si dëshmi .,
- Fëmijët viktimë të kenë të drejtë për ilaç juridik, siç është përcaktuar në legjislacionin nacional për reintegrim të plotë dhe rimëkëmbje .
- Fëmijët viktimë duhet të kenë qasje në shërbime për ndihmë dhe mbështetje, siç janë shërbimet financiare, juridike, këshillëdhënëse, shëndetësore, sociale dhe arsimore, shërbimet për rimëkëmbje fizike

¹ <https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>

² Neni 19, Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të lehtësuar riaftësimin fizik e psikologjik dhe riintegrimin në shoqëri të çdo fëmije që është viktimë: e çdo forme pakujdesie, shfrytëzimi ose keqtrajtimi, torture ose çdo forme tjetër të një trajtimi ose dënimi mizor, çnjerëzor e poshtëruës ose konflikti të armatosur. Ky riaftësim dhe ky riintegrim duhet të bëhen në kushtet e një mjedisi, që ndihmon shëndetin, personalitetin dhe dinjitetin e fëmijës.

³ Neni 3 1. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.

dhe fiziologjike dhe të gjitha shërbimet tjera të nevojshme për reintegrim të fëmijëve përmes organizatave qeveritare, vullnetare dhe organizatave tjera).

- Duhet të nxitet formimi, fuqizimi dhe zgjerimi i fondeve nacionale për kompensim të viktimave.⁴

2. Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

1. Të kuptojnë rëndësinë e intervistimit forenzik të fëmijëve
2. Të respektojnë parimet themelore nga të cilat burojnë të gjitha nenet e Konventës për mbrojtje e të drejtave të fëmijëve.
3. Të kontribuojnë në avancimin e mirëqenies së fëmijëve
4. Të zbatojnë drejtë legjislacionin, procedurat dhe praktikën në lidhje me intervistimin forenzik të fëmijëve
5. Të unifikojnë praktikën në rastet e tilla.
6. Të njohin mirë legjislacionet ndërkombëtare
7. Të aplikojnë metodat dhe teknikat e bisedës me fëmijën-viktimë e krimit, me qëllim që fëmija mos të riviktimizohet
8. Të krijojnë një mjedis të përshtatshëm për intervistim të fëmijëve

Përmbajtja e modulit të trajnimit

Sesioni 1

1. Intervistimi forenzik i fëmijëve
2. Parimet themelore nga të cilat burojnë të gjitha nenet e Konventës për mbrojtje e të drejtave të fëmijëve.

Sesioni 2

1. Kodi i drejtësisë për të mitur
2. Koordinimi Prokurori, Polici dhe organe tjera relevante

Sesioni 3

Ligji procedural, masat hetimore në legjislacionin e brendshëm

Legjislacioni ndërkombëtar (Koneventa Evropiane për të drejtën e Njeriut 1950, Konventa për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 1989-neni 3 i Konventës).

Metodologjia e trajnimit

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda interaktive, simulim i rasteve, punë në grupe, pyetje dhe diskutime nga pjesëmarrësit, zbulimi i praktikave më të mira për intervistimin e fëmijëve, etj.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit të DP-së dhe DKR-së.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të mbahet në tri sesione nga dy ditë.

⁴ https://www.unicef.org/northmacedonia/media/3441/file/MK_ProceduresChildrenVictimsOfViolence_Report_AL.pdf

Hyrje

Procedura e mbrojtjes së fëmijës nën moshën e përgjegjësisë penale

1. Për fëmijën nën moshën katërbëdhjetë (14) vjet nuk fillon procedura gjyqësore. Nëse fëmija është nën moshën katërbëdhjetë (14) vjet në kohën e kryerjes së veprës penale, çdo procedurë gjyqësore që ka filluar pushohet menjëherë dhe organi i kujdestarisë njoftohet për rastin nga policia pas konsultimit me prokurorin e shtetit për të mitur.
2. Sipas paragrafit 1 të këtij neni, Organi i kujdestarisë në bashkëpunim dhe koordinim me institucionet tjera ndërmerr veprimet e caktuara në pajtim me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e fëmijëve në trajtimin e kryerësve të veprave penale nën moshën katërbëdhjetë (14) vjeç.
3. Në afat jo më të gjatë se shtatë (7) ditë, e në raste urgjente jo më vonë se njëzet e katër (24) orë nga pranimi i informimit ose vënies në dijeni rreth kryerjes së ndonjë vepre penale të rëndë ose veprave të përsëritura, policia e informon dhe kërkon nga organi i kujdestarisë ndërmarrjen e masave urgjente adekuate për trajtimin dhe mbrojtjen e fëmijut kryes të veprës penale. Kjo masë urgjente e ndihmës përfundon në momentin kur organi i kujdestarisë përpilon programin e rregullt për mbrojtje dhe trajtim.
4. Sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, me akt juridik të nxjerrë nga Qeveria e Republikës të Kosovës rregullohet mënyra e mbrojtjes së fëmijëve kryes të veprave penale nën moshën e përgjegjësisë penale, programi i mbrojtjes, mbrojtja e fëmijës nën moshën e përgjegjësisë penale në situata urgjente, ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve, ndihma juridike dhe trajtimi i kësaj kategorie të fëmijëve, gjithnjë duke u bazuar në interesin më të mirë të fëmijëve.⁵

Veprimet procedurale

1. Kur zbatohet procedurë për vepër penale e kryer ndaj fëmijës, institucionet veprojnë me kujdes të posaçëm ndaj fëmijës i cili ka pësuar dëmtime nga vepra penale, duke e pasur parasysh moshën e tij, karakteristikat personale, nevojat e veçanta, edukimin dhe ambientin në të cilin jeton ai, në mënyrë që t'iu shmangen pasojave të mundshme të dëmshme për edukimin dhe zhvillimin e tij. Kontrollimi i fëmijës bëhet me ndihmën e pedagogut, psikologut ose të ndonjë eksperti tjetër profesional.
2. Gjyqtari kompetent do ta marr në pyetje fëmijun ose të miturin e dëmtuar me vepër penale, në pajtim me paragrafin 4. të këtij neni, ashtu që gjykata, prokurori i shtetit, i mituri dhe mbrojtësi mund të parashtrojnë pyetje e të mos jenë prezent në të njëjtin lokal me të dëmtuarin. Marrja në pyetje e fëmijut ose të miturit kryhet ashtu që pyetjet mund t'i parashtrojnë nëpërmjet gjyqtarit kompetent, ndërsa, sipas nevojës, me ndihmën e pedagogut, psikologut ose të personit tjetër profesional.
3. Fëmija ndaj të cilit është kryer vepër penale, mund të merret në pyetje si dëshmitar në shtëpinë e tij ose në ndonjë lokacion tjetër ku ndodhet ai ose në qendrën për punë sociale, apo përmes mjeteve teknike. Për marrjen e tillë në pyetje zbatohet paragrafi 4. i këtij neni.
4. Nëse fëmija ndaj të cilit është kryer vepra penale sipas nenit 108 të këtij kodi merret në pyetje si viktimë apo dëshmitar, marrja e tillë në pyetje zbatohet më së shumti dy (2) herë, dhe atë si në vijim:
 - 4.1. marrja në pyetje për herë të parë zbatohet me ndihmën e psikologut dhe udhëheqet nga ana e prokurorit të shtetit. Në pamundësi të sigurimit të psikologut, marrja në pyetje zbatohet nga ana e prokurorit, pa prezencën e tij;
 - 4.2. marrja në pyetje për herë të dytë bëhet me ndihmën e psikologut dhe udhëheqet nga ana e gjyqtarit kompetent. Në pamundësi të sigurimit të psikologut, marrja në pyetje zbatohet nga ana e gjyqtarit kompetent, pa prezencën e tij.

⁵ Kodi nr. 06/l-006 i drejtësisë për të mitur, neni 8, fq.6

5. Për njoftimin dhe prezencën e të pandehurit dhe të mbrojtësit të tij, të përfaqësuesit të të dëmtuarit si dhe përfaqësuesit ligjor të tij, në të gjitha fazat e procedurës penale, zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

6. Fëmiju si viktimë e veprës penale duhet të ketë përfaqësues të autorizuar në të gjitha fazat e procedurës penale. Për qëllim të këtij kapitulli, përfaqësuesi i autorizuar nënkupton përfaqësuesin, siç është përcaktuar në paragrafin 1. të nenit 63 të Kodit të procedurës penale.

7. Fëmiju merret në pyetje në ambient miqësor dhe të përshtatshëm për moshën dhe zhvillimin e tij si dhe nevojat e veçanta.

8. Marrja në pyetje mund të incizohet në audio dhe video dhe ai incizim transkriptohet fjalë për fjalë dhe mund të përdoret si provë.

9. Sipas paragrafit 8. të këtij neni, çdo incizim teknik i marrjes në pyetje përmes mjeteve teknike asgjësohet brenda pesë (5) viteve nga hyrja në fuqi e vendimit gjyqësor.

10. Gjyqtari kompetent e informon organin kompetent të kujdestarisë për faktet dhe provat e vërtetuara në procedurë penale të cilat kanë kontribuar ose kanë mundësuar kryerjen e veprës penale, në mënyrë që të ndërmerren masa për mbrojtjen e të drejtave dhe të mirëqenies së fëmijës.

Standardet dhe rregulla për drejtim të procedurës në prokurori

Procedura penale

Gjatë procedimeve penale ekzaminimi i një fëmije ose të mituri si palë e dëmtuar apo dëshmitar duhet të kryhet me ndihmën e një psikologu, pedagogu ose një profesionisti tjetër. Për të pasur sukses kjo, është e nevojshme që prezent të jetë edhe prindi apo kujdestari.

Deklarata regjistrohet me pajisje audiovizive, krejt kjo me qëllim të mbrojtjes së të miturit si palë e dëmtuar nga viktimizimi i mëtejshëm dhe ekzaminimet e përsëritura që mund të çojnë në dëmtimin e provave.

Zbatimi i këtyre dispozitave ende nuk ka zënë rrënjë në praktikën gjyqësore në një mënyrë që do të ishte e kënaqshme nga pikëpamja e veshtrimit psikologjik.

Në procedurën të cilën e drejton ose në të cilën merr pjesë prokurori, fëmijët mund të paraqiten në cilësi të ndryshme:

- si autorë të veprës penale,
- si viktimë të veprës penale dhe
- si dëshmitar të procedurës.

Fëmija ka të drejtë të informohet nga të gjitha institucionet, të cilat vijën në kontakt me të, në lidhje me të drejtat e tij, të cilat përfshijnë detyrime dhe përgjegjësi, të përcaktuara me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe dokumentet tjera ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve. Fëmija ka të drejtë të merret në pyetje, të dëgjohet dhe të mësohet për të drejtat e tij brenda procedurës dhe në lidhje me vetë procedurën. Fëmija mbi moshën 14 vjeçare, edhe në kuadër të veprimit joformal të organeve dhe shërbimeve kompetente, edhe në procedurën gjyqësore, i ka të garantuar të drejtat e njëjta, të cilat i kanë personat e rritur, të paditur në procedurë penale ose të kundërvajtjes, gjegjësisht të drejtat e posaçme të pranuar me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe marrëveshjet tjera ndërkombëtare të ratifikuara, në të gjitha fazat e procedurës dhe në shqiptimin dhe kryerjen e cilitdo sanksion ose masë.

Edhe për fëmijët vlen parimi i prezumimit të pafajësisë, ashtu që nuk mund të llogaritet se fëmija ka rënë ndesh me ligjin, përderisa një gjë e tillë nuk verifikohet me vendim të plotfuqishëm gjyqësor. Procedurat, në të cilat ka të përfshirë fëmijë janë të karakterit emergjent (të shpejtë), ashtu që prokuroria dhe institucionet tjera e kanë për detyrë të veprojnë në afat të arsyeshëm, në mënyrë që t'i mbrojnë interesat e

fëmijës. Në punën e vetë prokurori vepron me kujdes të posaçëm ndaj viktimave të veprave penale, duke iu dhënë mësim për të drejtat e tyre, kujdeset për interesat e tyre gjatë marrjes së vendimeve për përndjekje penale kundër të pandehurit, gjegjësisht gjatë marrjes së veprimeve në procedurën penale, në të cilën viktimat duhet personalisht të marr pjesë, për çka hartohet shënim zyrtar ose proces verbal.

Kategoritë vulnerabile kanë të drejtë për masa të posaçme të procesit të mbrojtjes gjatë dhënies së deklaratës dhe marrjes në pyetje në të gjitha fazat e procedurës, gjegjësisht nëse në kohën e dhënies së deklaratës janë nën moshën 18 vjeçare.

Masat e posaçme të procesit të mbrojtjes i përcakton gjykata me propozim të prokurorit, viktimës ose vlerësimit personal kur është e nevojshme të mbrohen viktimat e rrezikuara dhe në veçanti të ndjeshme.

Gjatë vendosjes për përcaktim të masave të posaçme për procesin e mbrojtjes, gjykatësi duhet ta marr parasysh vullnetin e viktimës. Gjykata duhet të përcaktojë masa të posaçme të procesit të mbrojtjes në raste, në të cilat gjatë dhënies së deklaratës viktimat janë nën moshën 18 vjeçare, edhe atë:

- kur fëmija-viktimë ka nevojë për kujdes të posaçëm dhe mbrojtje ose
- kur fëmija është viktimë e trafikimit me njerëz, dhunës ose abuzimit seksual.

Mbrojtja e fëmijëve viktimat apo dëshmitarë

Interesi më i mirë i fëmijës

Çdo fëmijë viktimë apo dëshmitar, në kontekstin e këtij kapitulli, ka të drejtë që interesi i tij më i mirë të jetë konsiderata mbizotëruese.

1. Fëmija viktimë apo dëshmitar trajtohet pa asnjë lloj diskriminimi.
2. Fëmija viktimë apo dëshmitar i veprës penale trajtohet në mënyrë miqësore dhe të ndjeshme, që respekton dinjitetin e tij gjatë gjithë procedurave ligjore, duke marrë parasysh situatën personale dhe nevojat e afërta dhe të veçanta, moshën, gjininë, aftësitë e kufizuara, nëse ka, dhe nivelin e pjekurisë së tij.
3. Ndërhyrja në jetën private të fëmijës kufizohet në minimumin e nevojshëm, siç përcaktohet në ligj, me qëllim sigurimin e standardeve të larta të dhënies së dëshmisë dhe një rezultat objektiv dhe të paanshëm të procedurave.
4. Mbrohet fshehtësia e informacionit lidhur me fëmijën viktimë apo dëshmitar.
5. Informacioni, që priret të bëjë identifikimin e fëmijës si dëshmitar apo viktimë, nuk botohet pa lejen e shprehur qartë të gjykatës.
6. Fëmija viktimë apo dëshmitar ka të drejtë t'i shprehë pikëpamjet, opinionet dhe bindjet e tij lirisht, me fjalët e tij, dhe ka të drejtë të japë kontribut për vendimet që ndikojnë në jetën e tij, përfshirë vendimet që merren gjatë procesit gjyqësor.

Kur zbatohet procedurë për vepra penale e kryer ndaj fëmijës, institucionet veprojnë me kujdes të posaçëm ndaj fëmijës i cili ka pësuar dëmtime nga vepra penale, duke e pasur parasysh moshën e tij, karakteristikat personale, nevojat e veçanta, edukimin dhe ambientin në të cilin jeton ai, në mënyrë që t'iu shmangen pasojave të mundshme të dëmshme për edukimin dhe zhvillimin e tij.

Kontrollimi i fëmijës bëhet me ndihmën e pedagogut, psikologut ose të ndonjë eksperti tjetër profesional.

Marrja në pyetje e fëmijës

Fëmija ndaj të cilit është kryer veprë penale, mund të merret në pyetje si dëshmitar në **shtëpinë e tij** ose në ndonjë **lokacion tjetër** ku ndodhet ai ose në qendrën për punë sociale, apo përmes mjeteve teknike.

Nëse fëmija ndaj të cilit është kryer vepra penale merret në pyetje si viktimë apo dëshmitar, marrja e tillë në pyetje zbatohet më së shumti dy (2) herë, dhe atë si në vijim:

- marrja në pyetje për herë të parë zbatohet me ndihmën e psikologut dhe udhëheqet nga ana e prokurorit të shtetit. Në pamundësi të sigurimit të psikologut, marrja në pyetje zbatohet nga ana e prokurorit, pa prezencën e tij;
- marrja në pyetje për herë të dytë bëhet me ndihmën e psikologut dhe udhëheqet nga ana e gjyqtarit kompetent. Në pamundësi të sigurimit të psikologut, marrja në pyetje zbatohet nga ana e gjyqtarit kompetent, pa prezencën e tij.

Fëmiu si viktimë e veprës penale

- Fëmiu si viktimë e veprës penale duhet të ketë përfaqësues të autorizuar në të gjitha fazat e procedurës penale.
- Fëmiu merret në pyetje në ambient miqësor dhe të përshtatshëm për moshën dhe zhvillimin e tij si dhe nevojat e veçanta.
- Marrja në pyetje mund të incizohet në audio dhe video dhe ai incizim transkriptohet fjalë për fjalë dhe mund të përdoret si provë.
- Gjyqtari kompetent e informon organin kompetent të kujdestarisë për faktet dhe provat e vërtetuara në procedurë penale të cilat kanë kontribuar ose kanë mundësuar kryerjen e veprës penale, në mënyrë që të ndërmerren masa për mbrojtjen e të drejtave dhe të mirëqenies së fëmijës.

Veprimi me fëmijë autor të veprave penale (të cilat njëkohësisht mund të jenë edhe viktima të veprës penale)

Prokuroria gjatë veprimit të saj e ka për detyrë t'i respektojë dhe mbrojë të drejtat e fëmijës pa kurrfarë diskriminimi, pavarësisht gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, përkatësisë së grupeve të marginalizuara, përkatësisë etnike, gjuhës, nënshtrësisë, prejardhjes religjionit ose besimit fetar, llojeve tjera të besimit, arsimit, përkatësisë politike, statusit personal ose shoqëror, paaftësisë mendore ose fizike, moshës, gjendjes familjare ose civile, statusit të pronës, gjendjes shëndetësore ose çfarëdo qoftë baze e paraparë me ligj ose me marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare.

Fëmijët deri në moshën 14 vjeçare nuk mbajnë përgjegjësi juridiko-penale, në fakt vetë Kodi përcakton se nuk është zbatueshëm ndaj fëmijës, i cili gjatë kryerjes së aktit, që me ligj parashihet si veprë penale, ende nuk i ka mbushur 14 vjeç. Për veprën e fëmijës deri në moshën 14 vjeçare, e cila me ligj parashihet si veprë penale, prokuroria në parim nuk do të iniciojë procedurë, për të evituar ndikimin e dëmshëm ndaj fëmijës.

Në parim procedura iniciohet vetëm në rastet e parapara si vepra penale, nëse fëmija mbi moshën 14 vjeçare kryen veprë të përcaktuar si veprë penale, për të cilën parashihet dënim me burg deri në tre vite ose dënim më të rëndë, ose në rast kur qëllimi i masave ose sanksioneve të përcaktuara me Ligjin për drejtësi për fëmijë nuk mund të përmbushet pa procedurë të tillë.

Në procedurën para prokurorisë, fëmijët kanë të drejtë për avokat. Në rastet e veprimeve të fëmijës në rrezik deri në moshën 14 vjeçare, të cilat me ligj përcaktohen si vepra penale, për të cilat parashihet dënim me burg prej së paku pesë vite ose kur është i kanosur personaliteti, të drejtat dhe interesat e fëmijës, detyrimisht gjatë zhvillimit të bisedës merr pjesë edhe një avokat, i cili i mbron të drejtat dhe interesat e fëmijës.

Prezenca e avokatit është e detyrueshme edhe në rastet kur prokurori propozon masa për fëmijë në rrezik mbi moshën 14 vjeçare, për veprime të cilat me ligj përcaktohen si vepra penale, gjegjësisht për të cilat përcaktohet dënim me burg prej tre vjet, nëse sipas vlerësimit të qendrës është i rrezikuar personaliteti, të drejtat dhe interesat e fëmijës dhe nëse në kuadër të ekipit profesionist nuk ka jurist. Nëse fëmija është në dispozicion, atëherë ndërpritet procedura te prokurori , ndërsa e njëjta vazhdo, kur fëmija të jetë në dispozicion.⁶

Marrja e drejtpërdrejtë në pyetje dhe marrja në pyetje në mënyrë të tërthortë

Gjatë shpalojes së dëshmimeve në seancën kryesore, gjatë procedurës së provave parashihen tre mënyra të marrjes në pyetje:

- marrja e drejtpërdrejtë në pyetje, të cilën e bën pala, e cila e ka propozuar atë dëshmitar, forenzik (ekspert) ose këshilltar teknik,
- marrja në pyetje në mënyrë të kryqëzuar, që bëhet nga pala e kundërt dhe
- marrja në pyetje në mënyrë plotësuese, të cilën përsëri e bën pala, e cila e ka ftuar atë dëshmitar, forenzik ose këshilltar teknik.

Gjyqtari e ka për detyrë ta realizojë marrjen në pyetje në mënyrë të ndjeshme dhe të posaçme, me qëllim që ta zvogëlojë frikësimin potencial. Gjykatësi e ka për detyrë që gjatë gjykimit të sigurojë mbrojtje të plotë të fëmijës-viktimë dhe fëmijëve dëshmitare nga çfarëdo qoftë frikësimi. Marrja në pyetje bëhet në formë të bisedës së lirë me fëmijën viktimë, përkundër marrjes individuale në pyetje, gjegjësisht marrjes në pyetje të natyrës akuzuese.

Gjyqtari e ka për detyrë, që gjatë zbatimit të marrjes në pyetje në mënyrë të kryqëzuar, për së afërmi ta kontrollojë dhe mbikëqyre procedurën, që maksimalisht të pengohen dëmtimet edhe abuzimet të mundshme të fëmijëve. Përveç kësaj, nuk guxon të harrohet edhe fakti se aftësi e fëmijës për përqendrim të vëmendjes është shumë më e vogël nga ajo e të rriturve, andaj gjithnjë kur ka nevojë, gjykatësi duhet të mundësojë pauza adekuate gjatë marrjes në pyetje, ose ta kufizojë numrin e pyetjeve, të cilat mund t'i parashtrohen fëmijës, me çka do të ruhet vëmendja e tij dhe do të sigurohet dëshmi cilësorë.

Gjyqtari e ka për detyrë ta sigurojë dhe garantojë të drejtën e fëmijës-viktimë, se nëse nuk bëhet fjalë për rrethana të jashtëzakonshme gjatë procesit gjyqësor, atëherë fëmija viktimë vetëm njëherë do të merret në pyetje. Gjyqtari e ka për detyrë t'i mundësojë fëmijës-viktimë të drejtën, që kur palët ta marrin në pyetje, në rastet kur palëve në procedurën gjyqësore iu jepet mundësi që drejtpërsëdrejti t'i marrin në pyetje fëmijët, ta bëjnë atë në mënyrë thjeshtë, duke përdorë gjuhë të rëndomtë dhe dukë e pasur parasysht shkallën e kuptimit dhe vulnerabilitetit të fëmijës, gjegjësisht të mos e pengojnë aftësinë e tij për të dhënë përgjigje të sakta dhe precize. Gjyqtari mund të sigurojë dhe lejojë prezencë të personave tjerë për shkak të dhënies ndihmë të fëmijës, gjatë marrje së tij në pyetje, nëse konsideron se fëmija-viktimë gabimisht e ka kuptuar pyetjen e parashtruar ose nuk e ka kuptuar atë plotësisht. Gjyqtari i e ka për detyrë, kur të lejojë marrje në pyetje në mënyrë të kryqëzuar, ta ndjek me kujdes dhe kontrollojë mënyrën dhe llojin e pyetjeve të parashtruara, gjegjësisht mënyrën sesi parashtrohen pyetjet.

Gjyqtari e ka për detyrë të pengojë taktika të ndryshme, të cilat i përdorin avokatët e mbrojtjes, si për shembull parashtrimi i pyetjeve jorelevante, të cilat kanë për qëllim ta frikësojnë ose shqetësojnë fëmijën-viktimë ose fëmijën dëshmitar; parashtrimi i shpejtë i pyetjeve ose përsëritja e tyre, me çka synohet të hutohet fëmija-viktimë dhe të prolongohet përgjigja; parashtrimi i pyetjeve me përdorim të gjuhës, e cila nuk iu përputhet shkallës së zhvillimi të fëmijës-viktimë ose fëmijës dëshmitar; ose konkretisht në raste të abuzimit seksual, imponimi i konkluzionit, se akti është kryer me pëlqim të fëmijës-viktimë; ose parashtrimi i pyetjeve në lidhje me jetën dhe përvojat seksuale të fëmijës në të kaluarën.

⁶ https://www.unicef.org/northmacedonia/media/3441/file/MK_ProceduresChildrenVictimsOfViolence_Report_AL.pdf

Gjyqtari e ka për detyrë që t'i pengojë dhe refuzojë si të palejueshme taktikat e këtilla të marrjes në pyetje, të cilat mund të kalojnë në frikësim dhe maltretim të fëmijës-viktimë, për shkak se mund të kenë ndikim negativ dhe të dëmshëm ndaj fëmijës-viktimë, gjë që mund të jetë shkas për dhënie të deklaratave jo të sakta.⁷

Ndalimi për t'u ballafaquar me të pandehurin

Fëmija-viktimë dhe fëmija dëshmitar i trafikimit me njerëz, dhunës dhe abuzimit seksual, viktimë dhe dëshmitar i veprimeve tjera që me ligj janë të parapara dhe veprave penale ndaj njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare, si dhe veprime tjera që me ligj parashihen si vepra penale, për shkak të natyrës së tyre, pasojave ose rrethanave tjera që e bëjnë fëmijën në veçanti të ndjeshëm dhe i shkaktojnë gjendje të rëndë shpirtërore, nuk lejohet të ballafaqohet me të dyshuarin, respektivisht me të pandehurin.⁸

Dëgjimi – biseda me fëmijën-viktimë

Përgatitja paraprake për bisedë me fëmijën – viktimë në lidhje me dhënien e dëshmisë Gjykatësi është i detyruar që për zhvillim të bisedës (intervistës) së suksesshme me fëmijën-viktimë paraprakisht të përgatitet dhe të planifikojë mënyrën se si do të zhvillojë bisedën⁹, me qëllim që t'i shmanget ndonjë shkeljeje eventuale të të drejtave të fëmijës-viktimë.¹⁰ Gjykatësi mund, ta planifikojë mënyrën e zhvillimit të bisedës në bashkëpunim me ekspertë të angazhuar për kujdesin dhe ndihmën e fëmijëve, ose të kërkojë ndihmë nga psikologu, punonjësi social ose ndonjë person tjetër profesional, me qëllim që bisedën dhe marrjen në pyetje të fëmijës-viktimë ose fëmijës dëshmitar ta bëjë në mënyrë që do të mbrojë të drejtat e fëmijëve, me çka mënyrë nuk do të shkaktojë ndonjë shkelje ose dëmtim shtesë të personalitetit të tyre, respektivisht zhvillimit të tyre.¹¹

Pjesëmarrja e detyrueshme e psikologut

Në çdo fazë të procedimit penal me të miturit në konflikt me ligjin, si dhe gjatë pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga mosha mbi ose nën 14 vjeç, prania e psikologut është e detyrueshme.

Psikologu garanton, sipas rastit, mbështetjen psikologjike të të miturit dhe vlerëson thëniet e tij, në përputhje me zhvillimin mendor.

Prania e psikologut synon që të miturit në konflikt me ligjin, të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar t'i sigurohet pyetja në mënyrën e duhur dhe t'i lehtësohet dhënia e dëshmisë nga ana e tij, duke bërë kujdes për të eliminuar frikësimin ose ndrojtjen e të miturit nga procesi.

Organet kompetente, sipas rastit dhe nëse kjo është e mundur, kujdesen që të sigurojnë praninë e të njëjtit psikolog gjatë gjithë procesit të drejtësisë penale për mitur dhe vetëm nëse kjo është në interesin më të lartë të të miturit. Psikologu, i cili kryen rolin e mbështetësit emocional të fëmijës gjatë procesit të hetimit dhe gjykimit, nuk mund të caktohet nga gjykata për të marrë rolin e ekspertit, duke përgatitur vlerësim psikologjik për të njëjtin të mitur.¹²

⁷ https://www.unicef.org/northmacedonia/media/3441/file/MK_ProceduresChildrenVictimsOfViolence_Report_AL.pdf

⁸ https://www.unicef.org/northmacedonia/media/3441/file/MK_ProceduresChildrenVictimsOfViolence_Report_AL.pdf

⁹ <https://www.rolplatform.org/wp-content/uploads/2020/11/rol-children-alb.pdf>

¹⁰ <https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>

¹¹ https://www.unicef.org/northmacedonia/media/3441/file/MK_ProceduresChildrenVictimsOfViolence_Report_AL.pdf

¹²

<https://www.unicef.org/albania/media/1466/file/Flet%C3%ABpalosje%20p%C3%ABr%20gjyqtar%C3%ABt%20e%20SEKSIONE%20FAMILIARE.pdf>

Standarde ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve

1. Deklarata e OKB-së për të Drejtat e Njeriut - 1948 Deklarata i definon të gjitha të drejtat themelore të cilat i kanë të gjitha qeniet njerëzore, pa asnjë diskriminim. E njëjta, kishte një ndikim të madh dhe paraqet bazë për miratimin e shumë instrumenteve, standardeve dhe udhëzimeve tjera në sferën e të drejtave të njeriut.

2. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut - 1950

I identifikon të drejtat dhe liritë e patjetërsueshme që i gëzon çdo person dhe i detyron shtetet nënshkruese t'i garantojnë dhe mbrojnë këto të drejta, pa asnjë diskriminim. Me të njëjtën, janë miratuar edhe 14 protokolle me të cilat ndryshohen disa nga nenet origjinale ose shtohen disa të drejta shtesë dhe masa sigurie. Për shkeljen e të drejtave të cilat janë të garantuara me Konventë, kompetent është Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndërsa çdo individ (duke përfshirë edhe fëmijën), para të njëjtës mund të paraqesin padi kundër shtetit përkatës nënshkrues, duke përmendur llojin e shkeljes së të drejtës e cila është e garantuar me Konventë.

3. Konventa e OKB-së kundër Torturës dhe Trajtimt Mizor, Çnjerëzor dhe Poshtëruar - 1984 (së bashku me Protokollin Fakultativ të vitit 2002)

Konventa kundër torturës parashikon ndalimin e torturës, pa marrë parasysh kushtet dhe i detyron shtetet nënshkruese të ndërmarrin masa për të parandaluar çfarëdo torture apo ndonjë trajtim tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtëruar. Konventa kërkon nga shtetet që t'i hetojnë dhe ndjekin penalisht të gjitha rastet e pretenduara të torturës dhe të ofrojnë trajnim për parandalimin e torturës për të gjithë anëtarët e organeve të zbatimit të ligjit dhe ushtrinë. Parashikon krijimin e një Komiteti për luftë kundër torturës, i cili bën monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të Konventës dhe kërkon nga shtetet raportim të rregullt lidhur me zbatimin e saj.

Me Protokollin Fakultativ është parashikuar krijimi i mekanizmave preventivë nacional për parandalimin e torturës, të ngarkuar edhe për vizitën e vendeve ku personat mbahen në paraburgim, si dhe për pranimin e të gjitha ankesave lidhur me rastet e pretenduara të torturës dhe hetimi adekuat i të njëjtëve. I njëjti, parasheh edhe ekzistimin e Nënkomitetit për parandalimin e torturës, i cili ka të drejtë të kryejë vizita në të gjitha vendet ku ka të paraburgosur ose persona të burgosur në vendet nënshkruese.

4. Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore dhe Poshtëruar - 1987

Në bazë të nenit 3 të KEDNJ-së, Konventa më tej forcon mbrojtjen e njerëzve nga tortura eventuale, trajtimeve çnjerëzore dhe poshtëruar ose të ndëshkimit dhe e themelon Komitetin Evropian kundër Torturës (KET) i cili ka autorizim të vizitojë vendet ku ka të paraburgosur ose të burgosur dhe të paraqesë raporte te shtetet nënshkruese për rezultatet dhe konkluzionet e tyre.

5. Konventa për të Drejtat e Fëmijës – 1989

KDF-ja është konventë e pranuar gjerësisht, e ratifikuar nga të gjitha vendet e botës, përveç dy vendeve. Ajo ofron një spektër të gjerë të të drejtave të fëmijëve dhe i detyron shtetet nënshkruese që i mbrojnë të njëjtat. Shtetet janë të detyruara rregullisht të dorëzojnë raporte lidhur me zbatimin e këtyre të drejtave deri te Komisioni për të drejtat e fëmijës, i cili, mandej, përpilon rekomandime lidhur me gjendjen faktike rreth këtyre të drejtave në atë vend. Komisioni për të drejtat e fëmijëve ka hartuar 17 “Komente të Përgjithshme” shtesë të cilat përmbajnë interpretime më të detajuara për disa të drejta të fëmijëve të përfshira në Konventë. Nga ato, “Komenti i Përgjithshëm” numër 10 (2007) ka të bëjë me të drejtat në drejtësinë e të miturve.¹³

¹³ <https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>

6. Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës lidhur me drejtësinë sipas masave të fëmijëve 2010.

Janë vendosur rekomandime për trajtim dhe masa të cilat duhet të aplikohen për mbrojtje të të drejtave të gjithë fëmijëve që vijnë në kontakt me sistemet e drejtësisë në cilësinë e kryerësit, viktimës, dëshmitarit ose personave të tretë në procedurë (për shembull, në raste të kujdestarisë). Ato përmbajnë parime të përgjithshme dhe rekomandime specifike për çdo fazë të veçantë të procesit gjyqësor.

Burimet dhe literatura

Burimet dhe literatura e përdorur për hartimin temës si dhe literatura shtese që mund të përdoret lidhur me temën:

Kodi nr. 06/l-006 i drejtësisë për të mitur

Deklarata e OKB-së për të Drejtat e Njeriut – 1948

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut - 1950

Konventa e OKB-së kundër Torturës dhe Trajtitimit Mizor, Çnjerëzor dhe Poshtëruës – 1984

Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore dhe Poshtëruese - 1987

Konventa për të Drejtat e Fëmijës – 1989

<https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>

<https://www.unicef.org/albania/media/1466/file/Flet%C3%ABpalosje%20p%C3%ABr%20gjyqtar%C3%ABt%20e%20SEKSIONEVE%20FAMILIARE.pdf>

https://www.unicef.org/northmacedonia/media/3441/file/MK_ProceduresChildrenVictimsOfViolence_Report_AL.pdf

<https://www.rolplatform.org/wp-content/uploads/2020/11/rol-children-alb.pdf>

<https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>

https://www.unicef.org/northmacedonia/media/3441/file/MK_ProceduresChildrenVictimsOfViolence_Report_AL.pdf